



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M

Nr. 10, date 18.01.2019

PËR NDRYSHIMIN E PJESSHËM TË VKB NR. 51, DATË 14.4.2009 "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PJESSHME TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE QË KËRKOHEN PËR TRANSFERIM NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR", PËR HEQJEN NGA LISTA E PASURIVE TË TRANSFERUARA NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR, MIRATUAR ME VKM NR. 421, DATË 2.6.2010, TË NDRYSHUAR, TË PRONAVE ME NR RENDOR 17, 18, 19, 22, 23, SIPAS FORMULARIT PËR HEQJEN NGA INVENTARI I PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e datës 18.01.2019, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.2 shkronja "a" "c", neni 18, neni 54 shkronja "e", 55 pika 4 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore, të ndryshuar, VKM nr. 421, datë 2.6.2010 "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të bashkisë Shkodër, të qarkut Shkodër", të ndryshuar, raportit përfundimtar të auditimit dhe rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit nr. 491/15, datë 30.11.2017, urdhërit nr. 982, datë 12.12.2017 të kryetarit të bashkisë "Për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të auditimit të KLSH-së,

V E N D O S I :

1. Ndryshimin e pjesshëm të VKB nr. 51, datë 14.4.2009 "*Për miratimin e listës së pjesshme të pronave të paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të bashkisë Shkodër*".
2. Heqjen nga lista e pasurive të paluajtshme të transferuara në pronësi të bashkisë Shkodër, miratuar me VKM nr. 421, datë 2.6.2010, të ndryshuar, të pronave sipas formularit bashkëngjitur "*për heqjen nga inventari i pronave të paluajtshme shtetërore*", me numër rendor si më poshtë:

- a) Nr. rendor 17: ish zyrat e sektorit të I-rë të Nd/jes komunale banesa.
 - b) Nr. rendor 18: zyre e magazinë të sektorit të I-rë të Nd/jes komunale banesa.
 - c) Nr. rendor 19: ish dekori.
 - ç) Nr. rendor 22: ish zyrat e rajonit tek ndërmarrja artistike.
 - d) Nr. rendor 23: ish zyrat e rajonit tek ndërmarrja artistike.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
 4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 18.1.2019
Shpallur në datën 22.1.2019

Sekretar i këshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI


Pi-433. 4.2.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER
SEKTORI JURIDIK

Nr.102/1prot.

Shkodër, më 4.02.2019

LËNDA: Mbi vendimin Nr.10 datë 18.01.2019 të Këshillit të Bashkisë Shkodër.

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODER


Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të ligjit Nr. 107/2016 “Për Prefektin”, neni 8 germa a, neni 16 pika 2, neni 56 i KPAD, ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 9 pika 1.2 shkronja a dhe c, neni 18, neni 54 germa e, neni 55/4, ligjit Nr.8743 Dt.22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar, Ligjit Nr.8744 Dt.22.02.2001 “Për transferimin e pronave e paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, VKM Nr.421 dt.2.06.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjeshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës” i ndryshuar, Raportit përfundimtar të auditimit dhe Rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit nr.491/15 prot dt.30.11.2017, Urdhërit Nr.982 dt 12.12.2017 të Kryetarit të Bashkisë Shkodër “Për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të raportit përfundimtar të auditimit të KLSH-së”, shqyrtoi VKB Nr.10 dt.18.01.2019 Për ndryshimin e pjeshëm të VKB Nr.51 dt.14.04.2009 “Për miratimin e listës së pjeshme të pronave te paluajtshme shtetërore që kërkohen për transferim në pronësi të Bashkisë Shkodër”, për heqjen nga lista e pasurive të transferuara në pronësi të Bashkisë Shkodër, miratuar me VKM Nr.421 dt.2.06.2010 të ndryshuar, të pronave me numër rendor 17, 18, 19, 22, 23 sipas formularit për heqjen nga inventari i pronave të paluajtshme shtetërore-sipas relacionit bashkëlidhur¹”.

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore, për vazhdimin e procedurave strukturën përgjegjëse në Ministrinë e Brendshme për heqjen nga lista e VKM-së Nr.421 dt.2.06.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjeshme) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut të Shkodrës” i ndryshuar.

Me respekt,

PREFEKTI

Çesk MILLJA



¹ Konstatohet se procedura e ndjekur nga struktura përgjegjëse e bashkisë Shkodër është në vonesë maksimale.